REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PRISHTINËS OPŠTINA PRIŠTINA
09 -10- 2026
02-024/21-153080/26
NR. BR.

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E PRISHTINËS
OPŠTINA PRISTINA
MUNCIPALITY OF PRISHTINA

PRISHTINA

Universum International College
Powered by Arizona State University

UNI INTERNATIONAL COLLEGE SB
SH.P.K.
Nr. 2161/1 dt. 05.10.2026

MARRËVESHJE E BASHKËPUNIMIT

E lidhur ndërmjet:

1. **KOMUNËS SË PRISHTINËS – DREJTORISË SË SHËNDETËSISË**, me seli në Prishtinë, e përfaqësuar nga Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë, Dr.Bujar Gashi,

dhe

2. **KOLEGJI NDËRKOMBËTAR UNIVERSUM** me seli në Lipjan, përfaqësuar nga Isabel Salvat, Zëvendëspresidente për Çështje Akademike.

në vijim së bashku të referuara si "Palët",

duke shprehur vullnetin për bashkëpunim institucional në fushën e shëndetësisë, arsimit dhe zhvillimit profesional, si dhe për mbështetjen e institucioneve shëndetësore përmes donacionit, lidhin këtë:

MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

1. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është krijimi dhe zhvillimi i bashkëpunimit ndërmjet Palëve në fushën e shëndetësisë, arsimit dhe zhvillimit profesional, me synim:

1.1. avancimin e shërbimeve shëndetësore dhe përmirësimin e cilësisë së tyre;

1.2. zhvillimin profesional të studentëve dhe stafit shëndetësor;

1.3. mundësimin e praktikës profesionale për studentët e programeve përkatëse shëndetësore;

1.4. shkëmbimin e njohurive, përvojave dhe ekspertizës profesionale e akademike;

1.5. realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me interes publik;

1.6. mbështetjen e institucioneve shëndetësore të Komunës përmes donacionit dhe aktiviteteve të tjera të dakorduara;

1.7. zhvillimin e projekteve të përbashkëta akademike, praktike, kërkimore dhe shëndetësore.

2. Bashkëpunimi do të realizohet në përputhje me kompetencat ligjore të Palëve dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

Bashkëpunimi ndërmjet Palëve mund të përfshijë:

1. Organizimin dhe realizimin e praktikës profesionale për studentët e profileve shëndetësore, në pajtim me kapacitetet dhe mundësitë e institucioneve shëndetësore të Komunës;

2. Organizimin e trajnimeve, seminareve, ligjëratave, punëtorive dhe aktiviteteve të tjera profesionale;

3. Realizimin e aktiviteteve të përbashkëta edukative dhe promovuese në fushën e shëndetësisë;

4. Përfshirjen e ekspertëve dhe stafit akademik në aktivitetet e përbashkëta, sipas nevojës dhe marrëveshjes ndërmjet Palëve;

5. Zhvillimin e projekteve të përbashkëta në interes të komunitetit;

6. Shkëmbimin e përvojave, njohurive dhe praktikave profesionale;

7. Bashkëpunimin në aktivitete kërkimore dhe akademike, në përputhje me legjislacionin dhe rregullat institucionale në fuqi;

8. Realizimin e donacionit të përcaktuar me këtë Marrëveshje;

9. Aktivitete të tjera të cilat Palët i konsiderojnë me interes të përbashkët.

Neni 3

Mbështetja dhe kontributi i Kolegjit

1. Në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe përgjegjësisë sociale, Kolegji do të mbështesë Komunën dhe institucionet e saj shëndetësore, duke marrë përsipër të realizojë donacion në pajisje mjekësore ose pajisje të tjera të nevojshme për shërbimet shëndetësore, në vlerë jo më të vogël se 5,000.00 € (pesë mijë euro).

2. Pajisjet që do të jenë objekt i donacionit do të përcaktohen me dakordim ndërmjet Palëve, duke marrë parasysh nevojat dhe prioritetet e institucioneve shëndetësore të Komunës.

3. Pajisjet e donuara duhet të jenë në gjendje të përshtatshme për përdorim dhe, të shoqërohen me dokumentacionin përkatës, garancinë dhe dokumentacionin teknik.

4. Në shtojcën 1. e cila është pjesë përbërëse e Marrëveshjes do të përcaktohet lloji i donacionit që do të realizohet. Në shtojcë mund të shtohen ose ndryshohen pajisje, materiale ose artikuj të tjerë në funksion të qëllimit të kësaj Marrëveshjeje me dakordim me shkrim ndërmjet palëve.

5. Kolegji është përgjegjës për sigurimin dhe dorëzimin e pajisjeve të përcaktuara në Shtojcën 1. të kësaj marrëveshje.

6. Donacioni duhet të realizohet jo më vonë se data 30.11.2026, përveç nëse Palët me shkrim dakordohen ndryshe.

7. Dorëzimi dhe pranimi i pajisjeve do të bëhet përmes dokumentacionit përkatës të dorëzimit dhe pranimit, në pajtim me procedurat dhe aktet në fuqi të Komunës.

8. Donacioni i paraparë me këtë nen nuk krijon për Kolegjin të drejtë për trajtim preferencial, përfitim financiar, kontratë publike apo ndonjë përfitim tjetër të veçantë nga Komuna dhe nuk kushtëzon ushtrimin e kompetencave publike të Komunës.

9. Në rast se realizimi i donacionit kërkon plotësimin e ndonjë procedure apo miratimi të veçantë ligjor ose administrativ, Palët obligohen të veprojnë në përputhje me procedurat përkatëse.

Neni 4

Detyrimet e Drejtorisë

Drejtoria obligohet:

1. Të koordinojë organizimin e praktikës profesionale, sipas kapaciteteve dhe mundësive të institucioneve shëndetësore të Komunës;

2. Të përcaktojë, në bashkëpunim me Kolegjin, institucionet dhe njësitë shëndetësore ku mund të zhvillohet praktika profesionale;

3. Të caktojë personat përgjegjës për koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta;

4. Të bashkëpunojë në planifikimin dhe realizimin e aktiviteteve të përbashkëta;

5. Të sigurojë komunikimin dhe koordinimin institucional ndërmjet Palëve;

6. Të mbështesë aktivitetet e dakorduara brenda kompetencave të saj dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi;

7. Të mundësojë, kur është e përshtatshme, qasjen e studentëve në praktikën profesionale, duke respektuar rregullat e institucioneve shëndetësore, sigurinë e pacientëve dhe kapacitetet reale të institucioneve.

Neni 5

Detyrimet e Kolegjit

Kolegji obligohet:

1. Të realizojë aktivitetet e dakorduara në mënyrë profesionale dhe në përputhje me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje;

2. Të respektojë rregullat, procedurat dhe aktet e institucioneve publike dhe shëndetësore ku zhvillohen aktivitetet;

3. Të sigurojë që studentët e angazhuar në praktikë të plotësojnë kushtet dhe kriteret e kërkuara për praktikën profesionale;

4. Të sigurojë mbikëqyrjen dhe mentorimin akademik të studentëve gjatë praktikës, në bashkëpunim me personat përgjegjës të institucioneve shëndetësore;

5. Të garantojë respektimin e etikës profesionale, konfidencialitetit dhe rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe shëndetësore;

6. Të sigurojë cilësi dhe profesionalizëm në aktivitetet që realizohen në kuadër të kësaj Marrëveshjeje;

7. Të bashkëpunojë me Drejtorinë në arritjen e objektivave të përbashkëta;

8. Të realizojë donacionin e përcaktuar në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje, në pajtim me afatet, dhe procedurat e përcaktuara.

Neni 6

Praktika profesionale e studentëve

1. Praktika profesionale e studentëve do të organizohet në bazë të kapaciteteve të institucioneve shëndetësore të Komunës dhe nevojave të përcaktuara nga Drejtoria.

2. Para fillimit të praktikës, Kolegji do t'i dorëzojë Drejtorisë listën e studentëve, programin e praktikës dhe dokumentacionin përkatës të kërkuar.

3. Numri i studentëve, kohëzgjatja dhe orari i praktikës do të përcaktohen paraprakisht ndërmjet Palëve.

4. Studentët gjatë praktikës janë të obliguar të respektojnë rregullat e punës, etikën profesionale, udhëzimet e personelit shëndetësor dhe rregullat për mbrojtjen e pacientëve.

5. Studentët nuk do të kenë qasje në të dhënat personale dhe shëndetësore të pacientëve përtej asaj që lejohet me ligj dhe që është e domosdoshme për realizimin e praktikës.

6. Çdo përpunim, përdorim ose qasje në të dhënat personale dhe shëndetësore do të bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtat e pacientëve.

7. Kolegji dhe Drejtoria obligohen të ndërmarrin masat e nevojshme për ruajtjen e konfidencialitetit të të gjitha të dhënave dhe informatave të marra gjatë realizimit të kësaj Marrëveshjeje.

8. Praktika profesionale e studentëve në kuadër të kësaj Marrëveshjeje nuk krijon marrëdhënie pune ndërmjet studentëve dhe Komunës apo institucioneve të saj.

Neni 7

Koordinimi dhe zbatimi

1. Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, secila Palë do të caktojë një person përgjegjës për koordinim.

2. Personat përgjegjës do të komunikojnë dhe koordinojnë aktivitetet, afatet dhe mënyrën e realizimit të aktiviteteve të përbashkëta.

3. Për aktivitetet konkrete mund të përgatiten plane pune, programe ose dokumente të veçanta, të cilat nuk duhet të jenë në kundërshtim me këtë Marrëveshje.

4. Çdo aktivitet do të realizohet vetëm në kuadër të kompetencave ligjore dhe administrative të Palëve.

Neni 8

Shpenzimet dhe përgjegjësitë financiare

1. Kjo Marrëveshje, përveç donacionit të përcaktuar shprehimisht në nenin 3, nuk krijon detyrim financiar për asnjërën Palë, përveç nëse një detyrim i tillë përcaktohet me shkrim në një dokument të veçantë dhe në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2. Secila Palë i mbulon shpenzimet e veta që lidhen me aktivitetet e realizuara në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, përveç nëse Palët dakordohen ndryshe me shkrim.

3. Asnjëra Palë nuk mund të marrë përsipër detyrime financiare në emër të Palës tjetër pa autorizim paraprak me shkrim.

Neni 9

Pranimi i donacionit

1. Pranimi i pajisjeve të donuara do të bëhet nga Komuna ose institucioni kompetent i saj, në pajtim me procedurat dhe aktet në fuqi.

2. Për pranimin dhe dorëzimin e pajisjeve do të harto

het dokumentacioni përkatës i dorëzimit dhe pranimit.

3. Pajisjet e pranuara do të regjistrohen dhe menaxhohen në pajtim me rregullat përkatëse të Komunës dhe legjislacionin në fuqi.

4. Pas pranimit të donacionit, Kolegji nuk mund të kërkojë kthimin e pajisjeve të dhuruara, përveç rasteve kur një gjë e tillë lejohet shprehimisht nga legjislacioni në fuqi.

Neni 10

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave

1. Palët obligohen të ruajnë konfidencialitetin e çdo informacioni të marrë gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje që, sipas natyrës së tij ose sipas ligjit, konsiderohet konfidencial.

2. Në veçanti, Palët do të respektojnë legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin e të dhënave shëndetësore.

3. Asnjë e dhënë personale apo shëndetësore nuk mund të publikohet, kopjohet, transmetohet ose përdoret për qëllime të tjera nga ato të lejuara me ligj.

4. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit vazhdon edhe pas përfundimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 11

Monitorimi dhe raportimi

1. Palët do të bashkëpunojnë në monitorimin e realizimit të aktiviteteve të dakorduara.

2. Sipas nevojës, Palët mund të përgatisin raporte të përbashkëta për aktivitetet e realizuara.

3. Për donacionin e përcaktuar në nenin 3, dokumentacioni i dorëzimit dhe pranimit do të shërbejë si dëshmi për realizimin e tij.

Neni 12

Kohëzgjatja

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga përfaqësuesit e autorizuar të të dyja Palëve.

2. Marrëveshja lidhet për periudhën prej një (1) viti nga data e hyrjes në fuqi.

3. Vazhdimi i Marrëveshjes mund të bëhet vetëm me marrëveshje me shkrim ndërmjet Palëve.

Neni 13

Ndryshimi dhe plotësimi

1. Çdo ndryshim ose plotësim i kësaj Marrëveshjeje bëhet vetëm me shkrim dhe me pajtimin e të dyja Palëve.

2. Ndryshimet dhe plotësimet hyjnë në fuqi pas nënshkrimit nga përfaqësuesit e autorizuar të Palëve, përveç nëse përcaktohet ndryshe në dokumentin përkatës.

Neni 14

Ndërprerja e Marrëveshjes

1. Secila Palë mund ta ndërpresë këtë Marrëveshje para skadimit të afatit të saj, duke e njoftuar Palën tjetër me shkrim së paku tridhjetë (30) ditë paraprakisht.

2. Marrëveshja mund të ndërpritet për shkak të shkeljes së rëndë të detyrimeve të përcaktuara me këtë Marrëveshje, nëse shkelja nuk korrigjohet brenda një afati të arsyeshëm pas pranimit të njoftimit me shkrim.

3. Ndërprerja e Marrëveshjes nuk i cenon detyrimet e krijuara para datës së ndërprerjes.

4. Ndërprerja e Marrëveshjes nuk cenon rregullat ligjore që zbatohen për pajisjet e pranuara si donacion para datës së ndërprerjes.

Neni 15

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Palët do të përpiqen që çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje ta zgjidhin në mënyrë miqësore, përmes komunikimit dhe konsultimit institucional.

2. Në rast se mosmarrëveshja nuk mund të zgjidhet në mënyrë miqësore, çështja do të trajtohet nga organi kompetent, në pajtim me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Neni 16

Dispozitat përfundimtare

1. Kjo Marrëveshje nuk kufizon dhe nuk ndryshon kompetencat ligjore të asnjërës Palë.

2. Asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të interpretohet si delegim i kompetencave publike të Komunës te Kolegji ose anasjelltas.

3. Në rast se ndonjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje shpallet e pavlefshme ose e pazbatueshme, dispozitat e tjera mbeten në fuqi.

4. Çështjet që nuk janë rregulluar shprehimisht me këtë Marrëveshje rregullohen në pajtim me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

5. Shtojca për donacionin, e nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar të Palëve, konsiderohet pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

6. Kjo Marrëveshje është hartuar në dy (2) ekzemplarë origjinalë, nga një për secilën Palë, dhe të dy ekzemplarët kanë vlerë të njëjtë juridike.

7. Palët deklarojnë se e kanë lexuar, kuptuar dhe pranuar përmbajtjen e kësaj Marrëveshjeje dhe se ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë për bashkëpunim institucional.

PËR PALËT

KOMUNA E PRISHTINËS –
DREJTORIA E SHËNDETËSISË

Përfaqësuar nga:

Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë

Dr. Bujar Gashi

PËR KOLEGJIN NDËRKOMBËTAR UNIVERSUM

Përfaqësuar nga:

Dr.Isabel Salvat

Zëvendëspresidente për çështje Akademike.

SHTOJCA NR. 1
Përcaktimi i llojit të donacionit

Në bazë të Marrëveshjes për Bashkëpunim , të lidhur ndërmjet Komunës së Prishtinës – Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Kolegjit Universum të referuara si "palët", Palët dakordohen që donacioni të përfshijë pajisjet dhe materialet e mëposhtme, të destinuara për mbështetjen e aktiviteteve shëndetësore në terren dhe aktiviteteve publike shëndetësore.

Nr.	Përshkrimi i pajisjes	Destinacioni
1.	Pajisje teknologjike për QKMF	QKMF
2.	Pajisje mjekësore (aparat për matjen e tensionit, aparat për ultrazë, aparat për radiografi, stetoskop, oksimetra, glukometra, termometra mjekësor, nebulizatorë, EKG, aspirator mjekësor, aparat për matjen e peshës dhe gjatësisë, tavolinë mjekësore, karrocë mjekësore, shtrat mjekësor, autoklav, etj)	QKMF
3.	Artikuj të tjerë të nevojshëm për realizimin e qëllimit të marrëveshjes	QKMF

1. Vlera totale e donacionit do të jetë jo më e vogël se 5,000.00 € (pesë mijë euro), duke përfshirë të gjitha shpenzimet e sigurimit, transportit, dorëzimit dhe detyrimet e tjera përkatëse.
2. Sasitë, specifikimet teknike, modelet, vlerat dhe destinacionet përfundimtare të pajisjeve do të plotësohen dhe konfirmohen nga Palët, para dorëzimit të donacionit.
3. Pajisjet duhet të jenë të reja dhe funksionale për përdorim. Në raste të veçanta, pajisjet e përdorura mund të pranohen vetëm nëse janë në gjendje të përshtatshme teknike dhe funksionale dhe nëse kjo miratohet paraprakisht me shkrim nga Palët.
4. Pajisjet duhet të shoqërohen me dokumentacionin teknik, dokumentacionin e origjinës dhe dokumentacionin e garancisë, kur kjo është e aplikueshme.
5. Për pajisjet mjekësore, kur është e aplikueshme, duhet të sigurohet dokumentacioni përkatës që dëshmon përputhshmërinë, sigurinë dhe përshtatshmërinë e tyre për përdorim.
6. Dorëzimi dhe pranimi i pajisjeve do të bëhet përmes procesverbalit të dorëzim-pranimit, i cili do të përmbajë së paku: përshkrimin e pajisjeve, specifikimet teknike ose modelin, sasinë, vlerën, gjendjen, dokumentacionin përkatës dhe institucionin destinues.
7. Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e Marrëveshjes për Bashkëpunim dhe interpretohet në përputhje me dispozitat e saj.

Në kuadër të kësaj shtojce mund të përfshihen pajisje, mjete e artikuj të tjerë që janë në funksion të realizimit të qëllimit dhe aktiviteteve të pëcaktuara në marrëveshje.

Prishtinë, më 09.10.2026 2026

PËR KOMUNËN E PRISHTINËS –
DREJTORIA E SHËNDETËSISË

Dr. Bujar Gashi
Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë

Nënshkrimi: _____

PËR KOLEGJIN NDËRKOMBETAR UNIVERSUM

Dr.Isabel Salvat

Zëvendëspresidente për Çështje Akademike

Nënshkrimi: _____